

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues, Agim Ademi, anëtarëve të trupit gjykues Luljete Shabani dhe Afrim Shala, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit U.S nga Gj, rruga "Shaban dhe S. U nr., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat ..., nga Gji.për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1. të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I nr. 222/2015, të datës 18.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 14.07.2016, bie dhe në prezencë të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari U.S., nga i ati B, dhe nëna S e lindur K, i lindur, në Gj, ku edhe jeton, , i pa martuar, i punësuar në afër postës së vogël në, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datë,.. rreth orës 14,30 h, në rrugën "" në Gj, me dashje pa autorizim, ka blerë dhe poseduar me qëllim shitje substancë narkotike të llojit "e cila me ligj është e shpallur si substancë e rrezikshme, në atë mënyrë që gjatë kontrollit nga ana e pjesëtarëve të policisë së Kosovës, të njëjtit i janë gjetur dhe sekuestruar 16 paketime të vogla me substancë narkotike në sasi prej 8.8. gram, të cilat ishin të përgatitura për tu shpërndarë dhe shitur, dhe të njëjtat i sekuestrohen.

-me çka ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1. të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7,17, 21, 46,51, 69, 73, 75, 76,114 dhe 273 Par. 5 të KPRK si dhe neneve 365, 453 të KPPRK,

E G J Y K O N

Të akuzuarin U. S, me dënim të kushtëzuar burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti të cilin dënim nuk do ta vuaj nëse në periudhën e verifikimit prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht revokohet. Po ashtu të njëjtit i shqiptohet dënim gjobë në shumë prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro të cilën dënim me gjobë i akuzuari do ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit përndryshe dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgu duke i llogaritur nga 20 euro për një ditë burgim.

Të akuzuarit U. Si shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i substancës narkotike të llojit "...ë" në sasi prej 8.8 gram.

Obligohet i akuzuari që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 30 euro si dhe shpenzimet tjera sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda ka ngritur aktakuzë PP.I.nr. 222/2015, të datës 18.12.2015, kundër të akuzuarit U. S, nga Gjilani, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1. të KPRK-ës, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, Shaban Spahiu fillimisht mbeti në tërësi pran aktakuzës, deri sa në fjalën përfundimtare shtoi se nga provat e siguruara gjatë hetuesisë ashtu edhe nga deklarimi i të akuzuarit në seancën e sotme gjyqësore në të cilën seancë i akuzuari në tërësi e pranon fajësinë lidhur

me këtë veprë penale dhe që ky pranim korrespondon edhe me provat tjera në shkresat e lëndës si dhe me deklaratat e të akuzuarit të dhëna në Polici dhe në Prokurori e në prezencë të mbrojtësit të tij. Gjendja faktike është ndriçuar tërësisht në këtë çështje penale dhe nga e cila rezulton se i akuzuari U.S, me datë, kohë dhe mënyrën si në dispozitiv të aktakuzës e ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1. të KPRK-ës. Andaj propozoi trupit gjykues që të njëjtin ta shpalli fajtor dhe ti shqiptoi një dënim meritor sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit U. S, avokat në fjalën përfundimtare deklaroi unë si mbrojtës e akceptoi deklaratën e të akuzuarit gjatë shqyrtimit të sotëm gjyqësor i cili e ka pranua fajësinë për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e substancës narkotike dhe analoge nga neni 273 par.1. të KPRK, dhe kërkoi nga trupi gjykues që gjatë shqyrtimit të matjes së dënimit ti kushtoi kujdes më shumë rrethanave lehtësuese se sa atyre rënduese. Arsyeja është se i mbrojturi im pranon veprën penale si në procedurën paraprake e edhe tani, ka qenë korrekt, është pendua për veprimet e tija dhe është zotuar se në të ardhmen në asnjë mënyrë nuk do të ndeshet me ligjin, çka besoi se me dënimin që do ta merr do të ketë ndikim në të akuzuarin që në të ardhmen mos të kryej vepra tjera penale.

I akuzuari U.S, fillimisht e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, deri sa në fjalën përfundimtare deklaroi: se e përkrahu në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim av.dhe se pendohem thellë për kryerjen e kësaj veprë penale, te ky ves ka ndikuar shoqëria ime, tani jam punësuar, i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale të këtij lloji e as vepra tjera penale. I propozoi trupit gjykues që mundësisht të më shqiptoi një dënim sa më të but që është e mundur, ngase kjo është hera e parë që ndeshem me ligjin.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës si: foto dokumentacioni lidhur me peshën e substancës narkotike, vërtetim mbi konfiskimin e sendeve i datës 23.11.2015 dhe raportit mbi testin fushor të substancës narkotike të datë si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, dhe erdhi në përfundim se i akuzuari U.S., me dashje pa autorizim, ka blerë dhe poseduar me qëllim shitje substancë narkotike të llojit "...", në atë mënyrë që gjatë kontrollit nga ana e pjesëtarëve të policisë së Kosovës, të njëjtit i janë gjetur dhe sekuestruar 16 paketime të vogla me substancë narkotike në sasi prej 8.8. gram, të cilat ishin të përgatitura për tu shpërndarë dhe shitur, dhe në këtë ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1. të KPRK-ës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i

akuzuari e ka pranuar fajësinë si në polici, me rastin e dëgjimit të tij në prokurori, si dhe pranimin e fajësisë pa hezitim dhe në mënyrë bindëse edhe në shqyrtim gjyqësor, gjithashtu i njëjti ka shprehur keqardhje të thellë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, lloj i substancës narkotike, se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale ku më të rrezikuarit janë gjeneratat e reja. Andaj, në prezencë të rrethanave të shumta lehtësuese dhe mbështetur në dispozitat e neneve 75 dhe 76 të KPRK-së, të akuzuarit i shqiptoj dënim nën minimumin e paraparë ligjor, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues konfiskimi i substancës narkotike të llojit "Marihuanë" në sasi prej 8.8 gram është bazuar në nenin 69 dhe 273 par. 5 të KPRK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 202 /2015 Me datë. 14.07.2016**

Sekretarja juridike,
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues,
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krimeve të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.